



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

### **Nr. 37**

Datë: 26. 05. 2021. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Zuviq, Rifat Krasniq, Fazli Stollaj

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPC: Ylli Buleshkaj, drejtor.

Përkthyese: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

#### **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së Nr.36/2021.

#### **2. Aktivitetet e SKQZ-së:**

#### **3. Aktivitetet e ZRPC-së:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrim të partisë politike ‘Iniciativa Balli’
- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrim të partisë politike ‘Bošnjačka Stranka’
- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrim të partisë politike ‘Kosova Adalet Türk Partisi’

#### **4. Formimi i Këshillave të KQZ-së:**

#### **5. Të ndryshme**

## **1. Hyrje: znj.Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

**Valdete Daka:** Përshëndetje. Mirëseardhje për dy anëtarët e rind të KQZ-së, ju uroj sukses në punën e tyre! Shpresoj se do të kemi bashkëpunim, ndërkaq sa i përket rendit të ditës, a ka vërejtje ?

**Sami Kurteshi:** Po unë. Faleminderit, po meqë përbërja e KQZ-së ende nuk është e plotë, formimi i këshillave është një çështje e brendshme dhe, unë propozoj që në njëren nga mbledhjet e ardhshme ta shqyrtojmë. Sot, nuk mendoj të diskutojmë, meqë më mirë është kur të kompletohem. Edhe një çështje: në të kaluarën, mbledhjet janë mbajtur shpesh dhe, edhe sot mbledhjet mbahen por, kish qenë mirë që ne të caktojmë një ditë që si anëtarë të KQZ-së ta dimë orarin e KQZ-së. E di që jemi anëtarë të KQZ-së, por ne duhet ta dimë gjatë javës se kur kemi mbledhje nëse caktojmë ditët kur mbahen mbledhjet... Edhe për punën e këshillave, është më mirë...! Pra, të mos thirren mbledhjet për një kohë të shkurtër, e ne të mos jemi të përgatitur etj. Faleminderit...

**Valdete Daka:** Ne jemi anëtarë permanent të KQZ-së, dhe jemi të obliguar të jemi në punë. Mbledhjet caktohen siç, ka nevojë, edhe këshillat...Pra, sidomos kur janë zgjedhjet afati nuk mund të përcaktohet sic, është 48 orë...

Këshillat, duhet ti konstituojmë sepse, jemi në prag të zgjedhjeve ! Pavarësisht që nuk jemi të kompletuar. Kemi pasur kësi situate, me sa di në vitin 2019...Për të funksionuar, ne duhet t'i kemi këshillat të konstituuar...

**Ariant Elshani:** Sa i përket mbledhjeve të KQZ-së dhe këshillave, ne mund të kemi orar të takimeve...Jam dakord me propozimin, e kam kërkuar edhe unë një praktikë të këtillë...Lidhur me këshillat, e kemi në rend dite cështjen...! Unë, jamë për konstituimin e tyre...

**Florian Dushi:** Mund të caktojmë takime të rregullta për KQZ-në, por edhe për këshillat...Pastaj, mund të mbahen edhe mbledhje tjera...Sa u përket këshillave, unë jam që të konstituohen por, kur të jenë janëtarët e tjerë, kur të na bashkëngjiten, ndoshta do të na duhet t'i rishikojmë këshillat...

**Alim Rama:** Mendoj që është me rëndësi të shihet përvoja e anëtarëve të rijnë, ose ku ata duan të jenë... Mos pasja e këshillave për disa javë, nuk e prolongon punën e KQZ-së... Sa i përket mbledhjeve, edhe unë mendoj të kemi ditë të caktuara të mbajtjes së mbledhjeve të KQZ-së...

**Ibrahim Selmanaj:** Ne mundem me planifikuar mbajtjen e takimeve tonë...Ndërsa për këshilla, na mungojë dy por ne duhet të punojmë dhe, kjo nuk pengon...

**Valdete Daka:** Mirë, kush është për këtë rend dite?

Anëtarët e KQZ-së, me 5 vota për dhe 2 vota kundër ( Sami Kurteshi dhe Alim Rama) miratuan rendin e ditës.

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së miratuan edhe procesverbalin e mbledhjes së KQZ-së, nr.36/2021.

## **2. Aktivitetet e SKQZ-së:**

**Burim Ahmetaj:** Fillimisht, përshëndes anëtarët e rind të KQZ-së dhe ju uroj punë të mbarë...Sekretariati ka përgatitur draftin e Raportit të Punës së KQZ-së. Ky drafte, është përgatitur me të gjitha njësitë, dhe

partnerët e brendshëm dhe misionet e jashtme. Pra, KQZ mund ta diskutojë dhe ta trajtojë, dhe është i obliguar ta trajtojë raportin e punës...

Po ashtu, Sekretariati po përgatitet për zgjedhjet lokale të rregullta, pra po e përgatisim draft – planin. Po i përgatisim edhe procedurat teknike mbi shpalljen e tenderëve, dhe implementimi e tyre sipas kritereve, vendimeve dhe specifikave ligjore...

Zyra e auditorit Gjeneral ende nuk e ka përfunduar punën, por së shpejti do ta përfundoj punën dhe ne pastaj, e presim raportin. Sekretariati, po e përgatitë edhe raportin e 3 mujorit të parë të këtij viti...

**Valdete Daka:** A ka pyetje rreth raportit ?

**Sami Kurteshi:** Kur ne mund ta kemi draft – planin, por duhet të kemi mjafueshëm kohë..! A janë futur në draft-plan raportet e organizatave tjera, e që kanë rekomandime e propozime etj. ? Apo nuk ka...!

**Burim Ahmetaj:** Draft – planin do ta dërgojmë nesër...? Aty, janë edhe çështjet për të cilat po pyetni...! Ne, do t'ju raportojmë në detaje për secilin ndryshim, për secilin aktivitet...

**Valdete Daka:** Sa i përket BE-së, ata ende nuk e kanë sjellë raportin e zgjedhjeve, kurse nesër do kemi takim me ambasadorin e BE-së, dhe ndoshta do ta sjellin edhe raportin nëse e kanë të kryer...

**Alim Rama:** Kam disa pyetje: 1. Janë disa pozita në rekrutim e sipër. Unë kam një shqetësim, për zyrtarin e lartë për Listë Votues. Në panel janë drejtori, dhe 2 vartësit e drejtorit... Kësi panele, nuk sigurojnë transparencë... 2. Janë publikuar të gjitha procesverbalet e KQZ-së. Më ra në sy procesverbali i datës 14 mars, dhe unë nuk e di si ka ardhur sepse mbledhja nuk është mbajtje...Ka qenë një mbledhje përgatitore, konsultuese, dhe mbledhja në 16: 30 nuk është mbajtur...Si ka ardhur ky procesverbal se, mbledhja nuk është mbajtur... Por ne e kemi një procesverbal. Ju lutem nëse mundeni me na i formue: kur është mbajtur mbledhja dhe kush e ka votuar këtë procesverbal ? Tema ka qenë: "Kërkësë për Presidentin e Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi për shtyrjen e zgjedhjeve të Jashtëzakonshme të 15 marsit për kryetar të komunës në Podujevë".

Ne, mbledhjen se kemi mbajtur ! Për mua, është me rëndësi të dihet nga ka ardhur ky procesverbal ?

**Sami Kurteshi:** Nuk kemi marrë pjesë në trajtimin e këtij procesverbali. Unë, nuk e kam pasur...? Mirë është të sqarohet...

**Arianit Elshani:** Ka qenë situatë e jashtëzakonshme, zgjedhje të jashtëzakonshme. Është gjetur rasti i parë i personit me covid...E di që jemi thirrur nga ushtruesi i detyrës së Krye shefit kemi tentuar të lidhemi me skajb për shtyrjen e zgjedhjeve...Kemi diskutuar për procedimin e kërkësës ndaj Presidentit dhe nga ISHPK-ja... Kjo është e lehtë të sqarohet... Mbledhjen e kemi mbajtur në zyre të Krye shefit...

**Alim Rama:** Nuk thash që nuk kemi pasur takim konsultativ, por kemi diskutuar për kërkësën por nuk kemi votuar dhe nuk kemi miratuar një kërkësë të këtillë...Unë e kam ngritur këtë çështje edhe në qershori të vitit të kaluar, por ju keni thënë që kërkesa nuk ka shkuar në emër të KQZ-së... Kjo duhet të sqarohet...

**Valdete Daka:** Është e thjeshtë, procesverbalet janë... Mund të vërtetohet... !

### **3.Aktivitetet e ZRPP-së:**

**Yll Buleshkaj:** Ne, kemi dërguar për ju një imel se ku gjendemi ne si zyre me aktivitetet tona! Prandaj, veç aktivitetave që janë tanë në agjendë të takimit, ju njoftojë se ne jemi në shqyrtim edhe të një aplikacioni në shqyrtim të një partie politike, që më herët ka qenë e c'regjistruar... Por, ata mbasi që kanë kryer të gjitha detyrimet, kanë shprehur përsëri dëshirën për të aplikuar. Të gjitha rregullat ligjore prej fillimit, duhet të ndiqen nga ky subjekt për regjistrim...

Në vazhdim, z. Buleshkaj, dha shpjegime substanciale për rrëth tri partive të reja që kanë aplikuar për t'u regjistruar dhe se, sipas të gjitha procedurave që kërkojnë, të njëjtat kanë plotësuar kriteret dhe zyra i rekomandon për regjistrim.

Anëtarët e KQZ-së, me 8 vota për, miratuan rekomandimin për regjistrimin e subjekti të ri partiak: "Iniciativa Balli".

Anëtarët e KQZ-së, me 8 vota për, miratuan rekomandimin për regjistrimin e subjektit të ri partiak: "Bošnjačka Stranka".

Anëtarët e KQZ-së, me 8 vota për, miratuan rekomandimin për regjistrimin e subjekti të ri partiak: "Kosova Adalet Türk Partisi".

### **4.Formimi i Këshillave të KQZ-së:**

**Valdete Daka:** Vazhdojmë me konstituimin e këshillave të KQZ-së !

Rreth kësaj pike, u diskutua nga anëtarët e KQZ-së lidhur me konstituimin e këshillave, kompletimin e tyre, dhe pastaj, edhe rrëth kërkesës për shtyrjen e konstituimit të këshillave deri në konstituimin e plotë të KQZ-së.

Kryetarja Daka, fillimisht tha se ne e kemi një përbërje, por ne në vazhdim të shohim se si do të veprojmë me mirëkuptim, dikund ti plotësojmë, dikund të bëjmë ndryshime, varësisht edhe nga ajo se ku anëtarët e KQZ-së e shohin veten, apo duan të jenë që ta jepin kontributin e tyre...

**Florian Dushi:** tha se duke e parë këtë përbërje të tanishme, kish me qenë mirë që anëtarët e KQZ-së të deklarohen se a duan të vazhdojnë edhe më tej të jenë në të njëjtin këshill, ose janë të interesuar të jenë në ndonjë këshill tjeter. Kjo, është një mundësi. Kurse, unë personalisht nuk e shoh veten për shembull në këshillin ku ka qenë parardhësi im, pra në këshillin e buxhetit sepse mund ta jepë kontributin në ndonjë këshill tjeter...

**Sami Kurteshi:** Pra, pikërisht nga këto preferenca, për shkak të përgatitjes së anëtarëve etj., unë e shoh çështjen që të kompletoshet KQZ dhe, kjo të trajtohet mbas konstituimit sepse, ende nuk janë shpallur as zgjedhjet. Po kërkoj përsëri meqë kjo është një çështje interne...

**Ibrahim Selmanaj:** Unë, jam i gatshëm ta vazhdoj punën në të njëjtin këshill ku kam qenë...

**Alim Rama:** Edhe unë mendoj se konstituimi i këshillave kërkon një trajtim më të gjatë...

**Arianit Elshani:** Mendoj që, pavarësisht, do ta trajtojmë përsëri këtë çështje edhe kur të plotësohet KQZ...Pra, të mos e bllokojmë punën e Sekretariatit...

**Valdete Daka:** Të fillojmë pra së pari me Këshillin për Marrëdhënie me Jashtë... !

**Alim Rama,** duke bërë vërejtje lidhur me punën e këtij këshilli deri më tanj, propozoi që znj. Valdete Daka, meqë ajo është edhe kryesuese e KQZ-së dhe edhe ashtu e përfaqëson KQZ në marrëdhëni me jashtë, të mos mbetet në këtë këshill sepse, sipas z. Rama ky është edhe konflikt interes...

**Zonja Daka,** kundërshtoi këtë qëndrim të z. Rama dhe deklaroi se ka qenë periudhë e pandemisë dhe nuk ka pasur aktivitete, kontakte me jashtë dhe se ajo, kérkoi që të mbetet në këtë këshill si kryesuese...

**Sami Kurteshi,** tha se për një vit e më tepër nuk është mbajtur asnjë takim...por, në anën tjetër, ka pasur takime, dhe se ky institucion nuk ka dhënë asnjë informacion...Pra, edhe unë jam që kryetarja të mos jetë më kryesuese e këtij këshilli...

Nuk është mbajtur asnjë takim i këshillit dhe, edhe pse ka pasur takime të kryetares, KQZ nuk është informuar asnjëherë...

**Valdete Daka** tha se, këshilli ekziston për çështje të tjera, dhe jo për informim lidhur me takimet...

**Arianit Elshani,** e përkrahi faktin që ky këshill, të vazhdoj ta ketë anëtarë kryetaren e KQZ-së, si dhe vetë zonja Daka ta kryesoj edhe më tej këtë këshill...

Florian Dushi, tha se nga pozicioni që ka kryetarja dhe sidomos përfaktin që anëtarët e KQZ-së janë përfaqësues të partive kurse, kryetarja nga vetë përgjegjësitë që ka duhet të vazhdojë të jetë në këtë këshill...

Ndoshta ka pasur probleme, por ato duhet evituar...

**Ibrahim Selmanaj,** tha se e përkrah konstituimin e këtij këshilli dhe që aty, të jetë edhe kryetarja...

**Fazli Stollaj,** si anëtar i ri i KQZ-së, tha se është i gatshëm të marrë përgjegjësitë në këshilla...

**Sami Kurteshi,** tha se ne mund të diskutojmë përkrah këshillat por, duhet të plotësohet KQZ. Unë, tha ai, dhash arsyet e mia se pse kryetarja nuk ka plotësuar përgjegjësitë e veta, dhe se nga përbërja e tanishme, duhet të hiqet Valdete Daka...

Në vazhdim, **Alim Rama** kundërshtoi përbërjen e këtij këshilli, dhe diskutoi edhe njëherë rreth procesverbalit, por edhe e kundërshtoi faktin se këshilli nuk ka qenë i angazhuar...

Në këtë pikë, diskutoi përsëri edhe **Sami Kurteshi** që, kritikoi punën e kryetares Daka të cilën e cilësoi s'i jo korekte, ndërhyrëse etj. Ai, e konsideroi punën e znj. Daka si monopolizuese... Pastaj, diskutoi edhe Alim Rama, Arianit Elshani, i cili tha se përgjegjësia në këtë këshill është edhe e anëtarëve të këshillit, pastaj Ibrahim Selmanaj, dhe përsëri Sami Kurteshi, dhe në fund Florian Dushi.

Në vazhdim, u shqyrtuan dhe u konstituan të gjithë këshillat e KQZ-së, me gjithë debatet e ashpëra, mospajtimet e ndryshme mes anëtarëve të KQZ-së etj. Përbërja aktuale e këshillave, siç u tha disa

herë, do të rishikohet përsëri në një mbledhje të ardhshme, mbasi që do të konstituohet plotësisht KQZ:

**Listë e përbërjes së re të pesë (5) këshillave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:**

**I. Këshilli për Marrëdhëniet me Jashtë përbëhet nga:**

1. Valdete Daka, kryesues
2. Rifat Krasnic, zëvendës kryesues
3. Sami Kurteshi, anëtar
4. Florian Dushi, anëtar,
5. Fazli Stolaj, anëtar

**II. Këshilli për Personel përbëhet nga :**

1. Gordana Zuvic, kryesues
2. Ibrahim Selmanaj, zëvendës kryesues
3. Arianit Elshani, anëtar
4. Florian Dushi, anëtar
5. Alim Rama, anëtar

**III. Këshilli për Buxhet dhe Financa përbëhet nga:**

1. Arianit Elshani, kryesues
2. Ibrahim Selmanaj, zëvendës kryesues
3. Gordana Zuvic , anëtar
3. Fazli Stolaj, anëtar
5. , anëtar

**IV. Këshilli për Cështje Ligjore përbëhet nga :**

1. Florian Dushi, kryesues
2. Arianit Elshani, zëvendës kryesues
3. Sami Kurteshi, anëtar
4. Ibrahim Selmanaj, anëtar
5. , anëtar

**V. Këshilli për Operacione Zgjedhore përbëhet nga :**

1. Alim Rama, kryesues
2. Arianit Elshani, zëvendës kryesues
3. Florian Dushi, anëtar
4. Ibrahim Selmanaj, anëtar
5. Rifat Krasnic, anëtar